

**GJYKATA E QARKUT MITROVICE**

**P. No. 70/08**

**26 Gusht 2010**

**NE EMER TE POPULLIT**

**GJYKATA E QARKUT TE MITROVICES**, me Trupin Gjykues te përbërë nga Gjykatësja e EULEX-it Agnieszka Klonowiecka-Milart, si Kryetare e Trupit Gjykues dhe Gjykatësit e EULEX-it Charles L. Smith, III, dhe Nikolay Entchev, si Anëtarë te Trupit Gjykues, me pjesëmarrjen e Këshilltares Ligjore të EULEX-it Zane Ratniece si procesmbajtësë, në çështjen penale kundër:

**ARB NOR BAJRAKTARI**, i akuzuar, sipas Aktakuzës PP Nr 50/08 të Prokurores Publike datë 15-te Prill 2008, me Vrasje, sipas Nenit 146 paragrafi (1) i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK) dhe Lëndim i Lehtë Trupor, në bazë të nenit 153 paragrafi (2) të lexuar me paragrafin (1) të KPPK-se;

**BESART BAJRAKTARI**, i akuzuar, sipas Aktakuzës PP Nr 50/08 të Prokurores Publike datë 15-të Prill 2008, me Pjesëmarrjen në Rrahje, në bazë të Nenit 155 paragrafi (1) të KPPK-se; dhe

**ISA BAJRAKTARI**, i akuzuar, sipas Aktakuzës PP Nr 50/08 të Prokurores Publike datë 15-të Prill 2008, me Pjesëmarrjen në Rrahje, në bazë të Nenit 155 paragrafi (1) të KPPK-se; dhe

Pas mbajtjes se seancave kryesore te hapura për publikun më 23, 25 dhe 26 Gusht 2010, në prani të të Akuzuarit Arbnor Bajraktari, Avokatit Mbrojtjes Mahmut Halimi, të Akuzuarit Besart Bajraktari, Mbrojtjesit te tij avokatit Agim Lushta, të Akuzuarit Isa Bajraktari, Prokurores Publike te EULEX-it Neeta Amin, palës së dëmtuar Mexhit Beqiri (babai i të ndjerit, Viktimes Beqiri Armend) (përveç pales së dëmtuar Mexhit Beqiri, qe nuk ishte i pranishëm në seancën e 25-së dhe 26-të Gushtit 2010);

Pasi ka pranuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë në seancën shqyrtimit kryesor më 25 Gusht 2010 dhe pas paraqitjes së marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë në të njëjtën ditë në Shkrimoren e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë

Pas diskutimit të trupit gjykues dhe votimit të mbajtur më 26 Gusht 2010;

Shpalli publikisht dhe në prani të të tre të Akuzuarve, Avokatit Mbrojtjes dhe Prokurores Publike te EULEX-it Neeta Amin në vijim këtë:

## AKTGJYKIM

### I.

I Akuzuari **Arbnor Bajraktari**, pseudonimi \_\_\_\_\_, emri i babait \_\_\_\_\_, emri i nënës \_\_\_\_\_, mbiemri i vajzërisë i nënës \_\_\_\_\_, i lindur më \_\_\_\_\_, në \_\_\_\_\_, me banim në \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_ nuk dihet që të jetë dënuar më parë, në paraburgim që nga 23 Mars 2008 deri më 28 Janar 2010, në arrest shtëpiak që nga 28 Janari 2010;

është

## FAJTOR

**sepse** në 22 Mars 2008 rreth orës 20:00, në Mitrovicë, gjatë një përleshjeje që ishte duke u zhvilluar në mes Besart Bajraktarit dhe te ndjerit Armend Beqiri, dhe Fidan Ferizit, Arbnor Bajraktari ndërhyri për të ndihmuar vëllain e tij Besart Bajraktari dhe pasi dëgjoji Fidan Ferizin te inkurajonte Armend Beqiri ta qellonte atë me thike, ai nxjerr një thikë nga xhepi i xhakëtës së tij dhe e godet me thikë Armend Beqirin, duke shkaktuar lëndime, si pasojë e të cilave Armend Beqiri vdiq.

Duke vepruar kështu, i Akuzuari Arbnor Bajraktari ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për veprën penale të vrasjes, sipas Nenit 146 paragrafi (1) të KPPK-së.

Për këtë veprë penale i Akuzuari Arbnor Bajraktari është

## DENUAR

me 6 / gjashtë / vjet burgim.

Koha e kaluar në paraburgim që nga data 23 Mars 2008 dhe në arrest shtëpiak që nga 28-të Janari 2010 do të kreditohet ndaj dënimit në përputhje me Nenin 73 paragrafi (1) të KPPK-së.

### II.

Akuza për Lëndim të Lehtë Trupor, në bazë të Nenit 153 paragrafi (2) lexuar me paragrafin (1) të KPPK-së, kundër të Akuzuarit **ARB NOR BAJRAKTARI, ESHT E HEDHUR POSHTE**, pas tërheqjes së akuzës nga Prokurorja Publike e EULEX-it, në përputhje me Nenin 389 (pika 1) të KPPK-së

### III.

Akuza e Pjesëmarrjes në Rrahje, në bazë të Nenit 155 paragrafi (1) të KPPK-së, kundër **BESART BAJRAKTARIT**, emri i babait , emri i nënës, mbiemri i vajzërisë së nënës , i lindur më , në , me banim në , në paraburgim që nga 23 Mars 2008 deri në 17-të Prill 2008, **ESHT E HEDHUR POSHTE**, pas tërheqjes së akuzës nga Prokurorja Publike e EULEX-it, në përputhje me Nenin 389 pika 1) i KPPK-së.

### IV.

Akuza Pjesëmarrje në Rrahje, në bazë të Nenit 155 paragrafi (1) të KPPK-së, kundër **ISA BAJRAKTARIT**, emri i babait , emri i nënës, emri i vajzërisë së nënës i lindur më , në , me banim në , në arrest shtëpiak që prej 23 Mars 2008 deri më 17 Prill 2008, **ESHT E HEDHUR POSHTE**, pas

tërheqjes së akuzes nga Prokurorja Publike e EULEX-it, në përputhje me Nenin 389 pika 1) i KPPK-së.

V.

I Akuzuari **ARB NOR BAJRAKTARI** do të rimbursojë shpenzimet e procedurës penale në pajtim me Nenin 102 paragrafi (1) të KPPK-se me përjashtim të shpenzimeve të përkthimit. Gjykata do të marrë një vendim të veçantë mbi shumën e shpenzimeve, kur të dhënat mbi keto do të merren në pajtim me Nenin 100 paragrafi (2) të KPPK-së.

## ARSYETIMI

### 1. JURIDIKSIONI I GJYKATES

#### 1.1. Çështja në fjalë dhe juridiksioni territorial

Në bazë të Nenit 23 paragrafi (1) të KPPK-së, gjykata e qarkut do të ketë juridiksion për të gjykuar në shkallë të parë një vepër penale të dënueshme me burgim prej së paku pesë vjet ose me burgim afatgjatë.

Aktakuza PP. No. 50/08, e Prokurores Publike datë 15 Prill 2008, *inter alia*, të akuzuarin Arbnor Bajraktari e ngarkon me Vrasje, sipas Nenit 146 paragrafi (1) të KPPK-së. Denimi i përshkruar për këtë vepër penale është të paktën pesë vjet. Prandaj, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë ka juridiksion lendor mbi rastin.

Veprat penale të ngarkuara kundër të tre të Akuzuarve pretendohet se janë kryer në Mitrovicë<sup>1</sup>.

Prandaj, në pajtim me Nenin 27 paragrafi (1) të KPPK-se, Gjykata e Qarkut të Mitrovicës gjithashtu ka kompetencë territoriale për çështjen.

#### 1.2. Kompetencat e gjyqtarëve të EULEX-it

Neni 3.3 i Ligjit No.03/L-053 "Për kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e gjykatësve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë" thekson se në

---

<sup>1</sup> Aktakuza e Prokurores Publike PP. No. 50/08, date 15 Prill 2008

rastet e kompetencave plotësuese, gjykatësit e EULEX-it mund të marrin përsipër një rast pas caktimit nga Kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it. Më 18 Nëntor 2009, Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, me kërkesën e Prokurores së EULEX-it, vendosi të caktojë në këtë çështje gjyqtarët e EULEX-it të Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës.

## **2. LIGJI NË FUQI**

Ligji i aplikueshëm material është ai në fuqi në kohën kur është kryer vepra penale. Më 22 Mars 2008, kur është kryer vepra, në fuqi ka qenë KPPK-ja, miratuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/25, në fuqi që nga 6 Prill 2004. Pas kryerjes së veprës penale (p.sh pas datës 22 Mars 2008) KPPK-ja është ndryshuar me ligjin nr 03/L-002. Ligji Nr 03/L-002 e ka ndryshuar KPPK-në duke përcaktuar *inter alia* se gjykata do të shqiptojë një vendim me dënim lehtësues kur kryerësi ka pranuar fajësinë, dhe Marrëveshja e fajësisë me shkrim përmban një klauzolë që parashihet zbutjen e dënimit. Në këtë rast kjo dispozitë e paraqitur si në KPPK me Ligjin nr 03/L-002 është më e favorshme për kryesin e veprës, sepse shton një faktor lehtësues ligjor. Prandaj, ndryshimet në përputhje me ligjin nr 03/L-002 për rastin në fjalë do të zbatohen në mënyrë retroaktive, në bazë të të qenurit më i favorshëm për kryesin e veprës.

Sa i përket ligjit procedural, gjykata ndoqi procedurën në bazë të KPPK-së, në fuqi në kohën e kryerjes së procedurave gjyqësore, sic është ndryshuar me Ligjin nr 03/L-003 që ka futur në KPPK, i titulluar më parë Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës (KPPPK), institucionin e marrëveshjes së fajësisë.

## **3. MARREVEESHJA MBI PRANIMIN E FAJËSISË**

### *3.1. Pranimi i marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë nga gjykata*

Prokuroria, i Akuzuari Arbnor Bajraktari dhe Avokati i tij Mbrojtjes bënë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, në datën 23 Gusht 2010, të nënshkruar nga Kryeprokurori Publik i EULEX-it më 23 Gusht 2010, dhe nga i Akuzuari Arbnor Bajraktari, Avokati i tij Mbrojtjes Agim Lushta dhe Prokurorja Publike e EULEX-it Neeta Amin më 24 Gusht 2010.

Marrëveshja me shkrim, e ndryshuar gjatë seancës së shqyrtimit kryesor më 25 Gusht 2010<sup>2</sup>, u pranua nga gjykata në kuadrin e mëposhtem:

***Së pari, sipas Nenit 308 A, Paragrafi (12) pikat (i), (ii) të KPPK-se:***

Gjykata vërtetoi se i Akuzuari Arbnor Bajraktari e kishte kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë. Kryetarja e Trupit Gjykues në seancën shqyrtimit kryesor më 25 Gusht 2010 personalisht e mori në pyetje Arbnor Bajraktarin, lidhur me, nëse ai e kishte lexuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe nese kjo ishte e qartë për të. I Akuzuari dha përgjigje konfirmuese. Më tej, Arbnor Bajraktari konfirmoi se pasojat e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë janë se pasi gjykata pranon marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, ai nuk mund të tërhiqet prej saj, dhe se, duke hyrë në marrëveshje mbi pranimin e fajësisë, ai e pranon kryerjen e veprës penale të Vrasjes.<sup>3</sup>

Gjykata vërtetoi që në nënshkrimin e marrëveshjes i Akuzuari Arbnor Bajraktari kishte qenë i përfaqësuar nga Avokati Mbrojtjes. Siç është shpjeguar nga Prokurorja Publike e EULEX-it Amin Neeta në seancën shqyrtimit kryesor më 25 Gusht 2010, Avokati Mbrojtjes i Arbnor Bajraktarit kishte kontaktuar Prokuroren Publike me kërkesën për të hyrë në marrëveshje mbi pranimin e fajësisë. Nga 18 Gusht - 23 Gusht 2010 Prokurorja Publike e EULEX-it Neeta Amin dhe Mbrojtjesi i të Akuzuarit Agim Lushta kanë patur takime në të cilat kanë diskutuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë.<sup>4</sup> Gjithashtu të Akuzuarit Arbnor Bajraktari i është dhënë kohë e mjaftueshme për t'u konsultuar me Mbrojtjesin e tij gjatë seancës së gjykimit kryesor, në lidhje me ndryshimet e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë.<sup>5</sup>

***Së dyti, sipas Nenit 308 A, Paragrafi (12) Pika (iii) të KPPK-së:***

Gjykata ka konstatuar se pranimi i fajësisë është mbështetur nga dëshmitë në dosjen e lendes:

a. Në marrëveshjen për pranimin e fajësisë në lidhje me bazën faktike është deklaruar se para ngjarjes, më 22 Mars 2008, herët, atë ditë në mes Besart Bajraktarit, shoku të tij dhe të ndjerit, Viktimes Armend Beqiri ka

<sup>2</sup> Procesverbali i Gjykimit Kryesor 25 Gusht 2010, f. 3-5 (në gjuhën Angleze)

<sup>3</sup> ibid, f5, 6 (në gjuhën Angleze)

<sup>4</sup> ibid, f.2 (në gjuhën Angleze)

<sup>5</sup> *Shih Procesverbalin e séances kryessore* 25 Gusht 2010, f.4 (në gjuhën Angleze)

pasur një mosmarrëveshje. Trupi Gjykues konstatoi se kjo deklaratë e fakteve në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë është mbështetur nga dëshmitë e mëposhtme në dosjen e lëndës:

Dëshmitari \_\_\_\_\_, më 23 Mars 2008, dëshmoi para Shërbimit Policor të Kosovës që në ditën e 22 Marsit 2010 ai ishte së bashku me Besart Bajraktarin. Ai dhe Besart Bajraktari u takuan me një grup prej tre personash, në të cilin përfshihej një person me emrin Fidan. Një person tjetër në grup filloi të sulmojë dhe të rrahë Besart Bajraktarin. Duke parë këtë, \_\_\_\_\_ u largua menjëherë.

Dëshmitari i vendngjarjes Fidan Ferizi, më 23 Mars 2008, dëshmoi *inter alia* për Shërbimin Policor të Kosovës që në ditën e 22 Marsit 2008 ai ishte së bashku me të ndjerin, Viktimen Armend Beqiri. Më herët, në ditën e 22 Marsit 2008, ndërsa Fidan Ferizi dhe Armend Beqiri ishin në Mitrovicë Armend Beqiri pati një konfrontim me një person, të cilin Fidan Ferizi nuk e njohte. Por gjatë identifikimit të fotove të të dyshuarve, më 23 Mars 2008, Fidan Ferizi identifikoi se ky person ishte Besart Bajraktari, vëllai i të Akuzuarit Arbnor Bajraktari. Fidan Ferizi dëshmoi gjithashtu se ky person, të cilin ai e identifikoi si Besart Bajraktari, para se të filloi keqkuptimi midis Besart Bajraktarit dhe Armend Beqirit, kishin qenë së bashku me një person tjetër.

b. Në marrëveshjen për pranimin e fajësisë në lidhje me bazën faktike është deklaruar më tej se i Akuzuari Arbnor Bajraktari ka hyrë në këtë përlëshje në mes të vëllait të tij Besart Bajraktarit dhe Armend Beqirit dhe Fidan Ferizit. Arbnor Bajraktari ka ndërhyrë për ti ndihmuar vëllait të tij. Kur Arbnor Bajraktari dëgjoi Fidan Ferizin që po inkurajonte Armend Beqirin për të qëlluar atë me thikë, Arbnor Bajraktari nxori një thikë dhe me atë thikë goditi Armend Beqirin një herë në pjesën e pasme të sipërme në të djathtë të trupit të tij, si rezultat i kësaj Armend Beqiri vdiq. Trupi gjykues konstatoi se kjo deklaratë e fakteve në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë është mbështetur nga dëshmitë e mëposhtme të gjendura në dosje:

Rrethanat e incidentit të dhëna nga dëshmitari Fidan Ferizi, në 23 Mars 2008, para Shërbimit Policor të Kosovës, ndryshojnë nga përshkrimi i tyre në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, pasi ai kishte deklaruar se kishte qenë ai dhe Armend Beqiri ata të cilët ishin duke u sulmuar dhe jo *vice versa*. Megjithatë, Fidan Ferizi gjithashtu theksoi se në vendin, ku Armend Beqiri u godit me thikë, ishte i pranishëm edhe personi, me të cilin Armend Beqiri kishte pasur më parë një mosmarrëveshje, dhe të cilin Fidan Ferizi e identifikoi si Besart Bajraktarin.

Fidan Ferizi theksoi se ky person (dmth, Besart Bajraktari) nuk e kishte goditur Armend Beqirin me thikë, kishte qenë ky personi tjetër.

Arbnor Bajraktari dhe Besart Bajraktari dëshmuan të dy, në 23 Mars 2008, para Shërbimit Policor të Kosovës që, pasi Arbnor Bajraktari kishte ndërhyrë, Fidan Ferizi e inkurajoi Armend Beqirin ta qëllonte me thikë atë (therrte). Besart Bajraktari, tha se në atë moment vëllai i tij Arbnor Bajraktari dhe Armend Beqiri filluan të përleshën. Dhe Arbnor Bajraktari, tha se ai vuri re një thikë në duart e Armend Beqirit, duke ngritur atë thikë me tëhun në drejtim të tij. Në momentin që Arbnor Bajraktari nxori thikën dhe me atë thikë goditi Armend Beqirin në pjesën e sipërme të trupit të tij.

Raporti i autopsisë, datë 24 Mars 2008, në lidhje me të vdekurin Armend Beqiri paraqiti që në pjesën e prapme të djathtë të shpatullës, ngjitur me krahun, ishte një vrimë, 3 centimetra e gjerë, dyshohet të jetë shkaktuar me një objekt të drejtperdrejte (thikë). Organet e tij të brendëshme (mushkëritë) ishin dëmtuar, dhe në bazë të patologut thellësia e penetrimit ishte mbi 7 centimetra. Ne raportin e autopsisë deklarohet që dyshohet se shkaku i vdekjes së tij ishte një therrje/goditje me një 'armë të ftohtë' (thikë).

Nga sa u përmend më lart gjykata konsideroi se pranimi i fajësisë së Arbnor Bajraktarit për veprën penale Vrasje është i mbështetur nga provat në dosjen e lëndës.

c. Marrëveshja për pranimin e fajësisë ka përfshire deklaratën se vrasja e Armend Beqirit paraqet një rast të besueshëm të mbrojtjes por edhe si jashtëzakonisht të nevojshme.

Sa i përket kësaj, trupi gjykues ka vlerësuar se në bazë të raportit të autopsisë, në datën 24 Mars 2008, i ndjeri Armend Beqiri ka një plagë të therrjes me thikë në pjesën e prapme të krahut të tij. Plaga në pjesën e prapme të krahut mund të shihet në fotografinë numër 12. Raporti i autopsisë ka treguar se nuk ka patur shenja të dhunës në pjesën e përparme të trupit të tij, gjë që tregon se Armend Beqiri është plagosur nga prapa. Arbnor Bajraktari ka dëshmuar para Shërbimit Policor të Kosovës në 23 Mars 2008, se posa e ka parë Armend Beqirin, i cili e ka ngritur thikën në drejtim të tij, ai e ka nxjerrë thikën e tij dhe e ka goditur me thike atë. Nga deklarata e Arbnor Bajraktarit mund të nënkuptohet se nuk ka pasur përleshje fizike në mes të Arbnor Bajraktarit dhe Armend Beqirit, e cila do të ndikonte në drejtim të therrjes me thikë. Më tutje, në bazë të raportit nga vendi

i ngjarjes, ne datën 22 Mars 2008, Armend Beqiri është gjetur i shtrire me fytyrë nga toka dhe në dorën e tij te majte ka pasur një kaçavidë. Nga kjo shihet se Armend Beqiri nuk është gjetur me thikë në dorë, por (objekti) mund të ishte dukur si thikë e jo kaçavidë, e cila gjithashtu ne çfarëdo rasti është e rrezikshme. Prandaj, trupi gjykues ka pranuar se pohimi i veprimit për vetëmbrojtje ka qene i besueshëm, ndonëse rrethanat nuk e kane liruar të pandehurin nga veprimi i tij - ai vullnetarisht i është bashkangjitur përleshjes fizike në mes të Besart Bajraktarit dhe Armend Beqirit, pa e vërtetuar se a ka pasur një sulm te paprovokuar.

***E treta, në bazë të Nenit 308 A, Paragrafi (12) pika (iv) e KPPK-së:***

Gjykata konstatoi që asnjëra prej rrethanave sipas Nenit 316, paragrafët (1) deri në (3) të KPPK-së, nuk ekzistojnë.

Duke u bazuar në marrëveshjen para-prirëse për pranimin e fajësisë, e cila është ndryshuar gjate shqyrtimit kryesor më 25 Gusht 2010, kjo marrëveshje është aprovuar nga Gjykata.

***3.2. Përfshirja e palëve të dëmtuara***

a. Marrëveshja e pranimit të fajësisë ka treguar se pala e dëmtuar Fidan Ferizi, nuk ka qenë e mundur të kontaktohet dhe se të gjitha përpjekjet e Prokurorisë për ta kontaktuar kanë dështuar. Gjykata ka vërtetuar se Fidan Ferizit i është dërguar thirrja, nga gjykata, për konfirmimin e aktakuzës dhe i është dërguar informacioni standart për te drejtat e palës së dëmtuar. Gjykata përsëri i ka dërguar thirrje Fidan Ferizit për shqyrtimin gjyqësor, siç është planifikuar fillimisht me datën 23, 24, 25 dhe 26 Gusht 2010. Kur gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesor më 23 Gusht 2010 ka vërtetuar se Fidan Ferizi nuk është paraqitur para gjykatës, gjykata ka dërguar edhe një thirrje, e cila, në 24-tër Gusht 2010, ne orën 11:30, i është dërguar personalisht në vendbanimin e tij. Fidan Ferizi nuk ishte prezent në vendin e tij të banimit, dhe siç është shpjeguar nga nëna e tij Bahrije Ferizi, e cila gjithashtu ka banuar aty, Fidan Ferizi ishte duke qëndruar në Francë.

b. Pala e dëmtuar Mexhit Beqiri (babai i të ndjerit viktimës Armend Beqiri) është thirrur nga gjykata për shqyrtimin kryesor, siç janë planifikuar seancat ne fillim me datat 23, 24, 25 dhe 26 Gusht 2010. Mexhit Beqiri ka qene prezent ne dëgjimin e shqyrtimit kryesor te parë në 23 Gusht 2010, dhe është informuar për negociatat e planifikuara në lidhje me marrëveshjen e pranimit te fajësisë dhe i

kane shpjeguar qëllimin e kësaj marrëveshje dhe pasojat. Ai është informuar për shqyrtimin gjyqësor të ardhshëm me datën 25 Gusht 2010,<sup>6</sup> dhe është inkurajuar për të diskutuar çështjen me prokuroren. Megjithatë ai nuk ka marrë pjesë në seancat e tjera të shqyrtimit kryesor. Marrëveshja për pranimin e fajësisë ka deklaruar se pala e dëmtuar Mexhit Beqiri është informuar mbi rezultatet e negociatave në lidhje me marrëveshjen e pranimit të fajësisë. Ashtu dhe siç është shpjeguar nga Prokurorja Publike e EULEX-it Neeta Amin, ajo është takuar me palën e dëmtuar Mexhit Beqiri për të diskutuar rreth kohëzgjatjes së marrëveshjes për pranimin e fajësisë, dhe i ka shpjeguar të drejtat e tij dhe arsyet për marrëveshjen e negociuar të fajësisë. Pas takimit, deklarata e Mexhit Beqirit, është përfshirë në marrëveshjen e fajësisë. Megjithatë, me vonë Mexhit Beqiri ka refuzuar për të nënshkruar deklaratën e palës së dëmtuar të përfshirë në marrëveshje.

Prandaj, gjykata ka ardhur deri në përfundimin se janë bërë përpjekje të mjaftueshme për të përfshirë palët e dëmtuara Fidan Ferizi dhe Mexhit Beqiri në procedurat penale, prandaj mungesa e tyre apo refuzimi për të marrë pjesë nuk mund të jete një pengesë në procedura në bazë të marrëveshjes për pranimin e fajësisë.

### 3.3. Dënimi

Gjate caktimit të dënimit të Arbnor Bajraktarit, gjykata ka marrë parasysh që prokuroria ka rekomanduar të jepet dënimi për 6 (gjashtë) vjet burgim.

Më pas gjykata ka marrë parasysh rrethanat lehtësuese në vijim:

- a. Në bazë të Nenit 66, paragrafi 3 i KPPK-së (siç është ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-002), gjykata ka konsideruar si rrethanë lehtësuese faktin që palët kanë hyrë në marrëveshje për pranimin e fajësisë. Gjithashtu në ditën pas incidentit, në datën 23 Mars 2008, kur i pandehuri Arbnor Bajraktari është marrë në pyetje nga Shërbimi Policor i Kosovës, ai ka pranuar që e ka therrur me thikë viktimën Armend Beqiri.
- b. Që nga 28 Janari 2010, i pandehuri Arbnor Bajraktari ka qenë në arrest shtëpiak, dhe gjate tërë kësaj kohe gjykata nuk ka marrë ndonjë njoftim të shkeljes së arrestit shtëpiak nga ana e tij, dhe Arbnor Bajraktari nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim për tu shmangur procedurës penale.
- c. Dëshmitë në lëndën e rastit kanë treguar se i pandehuri Arbnor Bajraktari ka goditur me thike për vdekje viktimën Armend Beqiri për shkak të sulmit që i është

---

<sup>6</sup> ibid, f.7 (në gjuhën Angleze)

bërë vëllait të tij Besart Bajraktarit, dhe për të parandaluar sulmin e të ndjerit viktimës Armend Beqiri kundër vete atij, të akuzuarit Arbnor Bajraktari.

d. Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë, e përkrahur nga provat, ka siguruar se Arbnor Bajraktari ka hasur rastësisht në përleshje, prandaj edhe nuk ishte nxitësi i incidentit, brenda të cilit është kryer vepra penale.

Duke i marrë parash këto rrethana, gjykata e ka pranuar dënimin me burgim prej 6 (gjashtë) vjetësh, siç është rekomanduar edhe nga Prokuroria, dhe e dënon të pandehurin Arbnor Bajraktarin me dënim prej 6 vjet burgim.

Koha e kaluar në paraburgim që nga 23 Marsi 2008 dhe arresti shtëpiak që nga 28 Janari 2010 do të llogaritet në dënim, në bazë të nenit 73 , paragrafi 1 i KPPK-se.

#### **4. AKUZAT E TJERA**

Në seancën shqyrtimit kryesor më 25 Gusht 2010, Prokurorja Publike e EULEX-it Neeta Amin tërhoqi akuzën e Pjesëmarrjes në Rrahje, në bazë të Nenit 155 paragrafi (1) të KPPK-se, kundër Besart Bajraktarit, dhe Isa Bajraktarit.

Prandaj, në bazë të Nenit 389 pika 1) të KPPK-se gjykata hodhi poshtë akuzën e pjesëmarrjes në një përleshje kundër Besart Bajraktarit, dhe Isa Bajraktarit.

Aktakuza PP Nr. 50/08, datë 15 Prill 2008, e akuzon të Akuzuarin Arbnor Bajraktari edhe me veprën penale Lëndim i Lehtë Trupor, në bazë të Nenit 153 paragrafi (2) të lexuar së bashku me paragrafin (1) të KPPK-se. Prokurorja Publike e EULEX-it Neeta Amin e tërhoqi këtë akuzë në seancën shqyrtimit kryesor më 26 Gusht 2010.

Prandaj, në bazë të Nenit 389 pika 1) të KPPK-se gjykata hodhi poshtë akuzën Lëndim i Lehtë Trupor kundër Arbnor Bajraktari.

## 5. Shpenzimet

I Akuzuari Arbnor Bajraktari do të rimbursojë shpenzimet e procedurës penale në pajtim me Nenin 102 paragrafi (1) të KPPK-se me përjashtim të shpenzimeve të përkthimit.

Një vendim i veçantë mbi shumën e shpenzimeve do të merret nga gjykata, kur të dhënat e tilla të jenë marrë në pajtim me Nenin 100 paragrafi (2) të KPPK-së.

### Gjykata e Qarkut në Mitrovicë P. No. 70/08

Përgatitur në gjuhën Angleze, një gjuhë e autorizuar.

Procesmbajtëse:

Kryetare e Trupit Gjykses:

Zane Ratniece

Këshilltare e EULEX -it

Agnieszka Klonowiecka-Milart

Gjykatëse e EULEX -it

Anëtarë të Trupit Gjykses:

Charles L. Smith, III

Gjykatës i EULEX-it

Nikolay Entchev

Gjykatës i EULEX-it

**Këshillë juridike:** Personat e autorizuar mund të paraqesin ankesë me shkrim kundër këtij vendimi në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë brenda 15 ditësh nga data e marrjes së kopjes së aktgjykimit, në përputhje me Nenin 398 paragrafi (1) të KPPK-se.